

VENDIM
Nr. 95, datë 20.5.2024

MBI MIRATIMIN E “KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI, ‘KESH’ SHA DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SHA, PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË FURNIZOHEN NGA ‘FSHU’ SHA”

Në zbatim të neneve 16, 20 germa “h”, 47, 56, germa “f”, si dhe 62, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të pjesës I, nenit 5, pika 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.5.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 987/1 prot., datë 14.5.2024, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, ‘KESH’ sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga ‘FSHU’ sh.a., për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”,

konstatoi se:

- Shoqëritë “KESH” sh.a., me shkresën e përbashkët me nr. 1889/2 prot., datë 23.4.2024, dhe “FSHU” sh.a., me shkresën nr. 2859/2 prot., datë 24.4.2024, protokolluar me tonën me nr. 987 prot., datë 24.4.2024, dërguan në ERE, për miratim, “Kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, ‘KESH’ sh.a., dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga ‘FSHU’ sh.a., për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”.

- Me marrjen e kësaj kontrate u realizua publikimi i saj në faqen e internetit të ERE-s, në [link-un: https://www.ere.gov.al/sq/publikime/konsultime/kontrata-ndermjet-kesh-sh-a-dhe-ftl-sh-a-per-shitje-blerje-depozitimin-shkembimin-e-energji-e-elektrike-per-periudhen-01-01-2024-31-12-2024](https://www.ere.gov.al/sq/publikime/konsultime/kontrata-ndermjet-kesh-sh-a-dhe-ftl-sh-a-per-shitje-blerje-depozitimin-shkembimin-e-energji-e-elektrike-per-periudhen-01-01-2024-31-12-2024)

- Kontrata e propozuar nga palët është e përberë nga 21 nene: shtojca 1: programet e livrimit sipas neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate; shtojca 2: sipas nenit 19, të kësaj kontrate, pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të palëve për regjistrimet telefonike; aneksi nr. 1: parashikimi i sasisë së plotë vjetore të konsumit të “FSHU” sh.a. për vitin 2024; aneksi 2 për rregullimet financiare të marrëdhënies së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, “KESH” sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”, ky aneks është i përberë nga 5 nene dhe nga shtojca 1 rakordim ditor “KESH” sh.a.–“FSHU” sh.a.

- Struktura e propozuar e kontratës së dakordësuar nga palët është thujtse e njëjtë me strukturën e kontratës së miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 278, datë 25.9.2023.

- Në ndryshim nga kontrata e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 278, datë 25.9.2023, e cila ka 22 nene, kontrata e dakordësuar nga palët për vitin 2024 ka 21 nene, pasi neni 22 është bërë pjesë integrale si pikë 4, e nenit 21, me të njëjtën përmbajtje si më poshtë vijon: “Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barasvlershme, 2 (dy) për secilën palë”.

- Baza ligjore e referuar në kontratë për nënshkrimin e saj nga palët është:

- Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neni 20, germa “h”;

- Vendimi nr. 456, datë 29.6.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar;

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”;

- Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 347, datë 27.12.2022, “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregtimit e klerimit dhe e shlyerjes);

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009, i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë ‘KESH’ sh.a.”, i ndryshuar;

- Vendimi nr. 271, datë 19.9.2023, i Bordit të ERE-s, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Korporata Elektroenergjitike Shqiptare’ (KESH) sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;

- Vendimi nr. 164, datë 4.11.2019, i Bordit të ERE-s, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;

- Urdhri nr. 217, datë 29.12.2023, i ministrit përgjegjës për energjinë, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 28, datë 18.1.2021, ‘Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike’, i ndryshuar”;

- Vendimi i ministrit përgjegjës për energjinë nr. 936/1 prot., datë 14.2.2024 (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik) i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për vitin 2024.

- Nga vlerësimet e bëra të bazës ligjore të përdorur në kontratën e propozuar nga palët (KESH sh.a. dhe FSHU sh.a.) rezulton e plotë dhe në të njëjtën kohë ka reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur përgjatë vitit 2024. Respektivisht që prej 1 janarit 2024 është hequr gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike e shpallur në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin se pjesë integrale e kontratës së propozuar është dhe aneksi II “Për rregullimet financiare të marrëdhënies së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, ‘KESH’ sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”, ky aneks ka rregulluar të gjithë marrëdhënien financiare të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve për plotësimin e kërkesës së blerësit për energji për përmbushjen e detyrimit si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) për periudhën kohore

1.1.2024–31.12.2024. Marrëdhënien e shitjes dhe të blerjes së energjisë fizike ndërmjet palëve, për plotësimin e kërkesës së blerësit për energji për përmbushjen e rolit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF) që do të realizohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë “ALPEX” sh.a., në tregun e ditës në avancë.

- Për rrjedhojë, në bazën ligjore të kësaj kontrate një element i rëndësishëm është dhe vendimi i Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregimit, e klerimit dhe e shlyerjes).

- Lidhur me ndryshimet e evidentuara, në kontratën e propozuar nga palët “KESH” sh.a. dhe “FSHU” sh.a. për vitin 2024, nëpërmjet *email*-it të datës 7.5.2024, ERE iu drejtua shoqërisë “FSHU” sh.a., e cila solli shpjegimet për këto raste respektivisht:

- Në nenin 3 është shtuar përkufizimi “Instrument financiar”, “FSHU” sh.a. sqaron si më poshtë: kemi bërë përditësim të përkufizimeve sipas VKM-së nr. 46/2024, konkretisht “1. Në nenin 3, të pjesës I, shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje: ‘5. Në këtë vendim, fjalët “instrument financiar” nënkuptojnë marrëveshje për faturimin reciprok të diferencës midis çmimit klerues për njësi kohore të tregut (të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë) për ditën e lëvrimit me çmimin e parashikuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve, të cilat sigurojnë pjesëmarrësit ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg’”. Ky term është i nevojshëm në mënyrë të veçantë për aneksin II, i cili është pjesë e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike dhe rregullon të gjithë marrëdhënien financiare të shitjes dhe të blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve për plotësimin e kërkesës së blerësit për energji për përmbushjen e detyrimit si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024.

- Në nenin 9 është evidentuar një ndryshim nga kontrata e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 278, datë 25.9.2023, respektivisht në këtë nen, në pikën 2/a është ndryshuar dhe në pikën 2/b fatura sistemuese është parashikuar të bëhet vjetore, ka qenë parashikuar në kontratën e vjetshme 6-mujore dhe pagesa është brenda 45 ditëve nga data e fundit e lëvrimit, dhe ka qenë se pagesat sipas faturave sistemuese mes palëve do të bëhen brenda datës 30 janar të vitit pasardhës. “FSHU” sh.a., lidhur me këtë ndryshim ka dhënë sqarimin e mëposhtëm: “Ky ndryshim vjen si rrjedhojë e ndryshimeve të bëra me VKM-në nr. 46/2024 në VKM-në nr. 456/2022, në të cilën përcaktohet se: sasia e depozituar e Shoqërisë Publike të Prodhimit, për t’u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universal është sasia e mbetur nga prodhimi i burimeve të rinovueshme pas mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe plotësimit të nevojave të furnizimit të klientëve të Shoqërisë Publike të Furnizimit në Tregun e Lirë. Sasitë rakordohen me bazë mujore dhe shkëmbehen gjatë vitit për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe nevojave të Shoqërisë Publike të Furnizimit në Tregun e Lirë, bazuar në sasinë dhe programet e kërkuara nga Furnizuesi i Tregut të Lirë, për të cilat është rënë dakord ndërmjet palëve”.

- Lidhur me këtë ndryshim, palët kanë dakordësuar të reflektojnë ndryshimet e dala me VKM-në nr. 46/2024, por edhe në të njëjtën kohë të rregullojnë procesin e rakordimit duke marrë në konsideratë edhe kontrata të tjera të cilat janë të lidhura palët respektivisht, kontratën që “KESH” sh.a. lidh me “FTL” sh.a., ky element synon unifikimin e procesit të rakordimit të kontratave dhe në të njëjtën kohë unifikimin e detyrimit që lind për pagesat. “FSHU” sh.a., sikurse evidentuar më sipër, bën me dije se procesi i rakordimit për muajin e fundit të vitit realizohet deri në 25 janar dhe nuk është e mundur që të ketë një detyrim për pagesë për një periudhë kaq të shkurtër deri në 30 janar, në këtë mënyrë palët kanë dakordësuar që kjo pagesë të unifikohet 45 ditë nga data e fundit të lëvrimit. Në kontratën e dakordësuar nga palët nuk rezulton që të lindin detyrime financiare shtesë lidhur me këtë proces që pagesa e faturës sistemuese të realizohet 45 ditë nga data e fundit e lëvrimit.

- Në nenin 14 është evidentuar një ndryshim nga kontrata e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 278, datë 25.9.2023, respektivisht në këtë nen ndryshon germa “e”, duke futur konceptin faturë sistemuese 12-mujore, ndërkohë që ka qenë 6-mujore. “FSHU” sh.a., lidhur me këtë ndryshim, ka dhënë sqarimin e mëposhtëm: “Për të njëjtat arsye të sqaruara më sipër”. Në këto kushte, duke qenë se koncepti i faturës sistemuese është dhënë dhe në nenin 9 të kontratës vlerësojmë se qëndrimi i dhënë në shpjegimet e nenit 9 më sipër vlejnë edhe për këtë rast.

- Bazuar në nenin 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, palët kanë përcjellë nëpërmjet shkresës së përbashkët me nr. 1889/2 prot., datë 23.4.2024, dhe të “FSHU” sh.a. me nr. 2859/2 prot., datë 24.4.2024, protokolluar me tonën me nr. 987 prot., datë 24.4.2024, kontratën TIP për “Shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, ‘KESH’ sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, ‘FSHU’ sh.a., për furnizimin e klientëve universalë për periudhën kohore 1.1.2024–31.12.2024”, vlerësojmë se periudha duhet të shënohet në këtë mënyrë: dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Në bazën ligjore, vendimi i ministrit përgjegjës për energjinë, vlerësohet që nr. prot., dhe data të vendosen në këtë mënyrë: nr. __ prot., datë dd.mm.vvvv (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik) i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal.

- Në nenin 1 “Qëllimi i kontratës” vlerësohet që periudha kohore të shënohet: dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Në nenin 2, pika 3 vlerësohet të shënohet: “Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin vvvv është ai i miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. __ prot., datë dd/mm/vvvv”.

- Neni 12 vlerësohet të shënohet: “Kontrata është e vlefshme për periudhën dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Neni 18 të rishkruhet në kuadër të miratimit të një kontrate tip, pa cilësuar emrat e personave të kontaktit.

- Neni 21, pika 1 vlerësohet të rishkruhet duke hequr periudhën kohore dhe zëvendësuar si në vijim: “Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën kohore dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv”.

- Në emërtimin e aneksit nr. 1, viti 2024, të zëvendësohet me vvvv.

- Në emërtimin e aneksit nr. 2, periudha kohore 1.1.2024–31.12.2024, vlerësohet të zëvendësohet me: dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Në nenin 1, pikën 1.1, të aneksit nr. 2, periudha kohore vlerësohet të zëvendësohet me: dd/mm/vvvv–dd/mm/vvvv.

- Në shtojcën nr. 1, viti 2024 vlerësohet të zëvendësohet me: viti [vvvv].

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës tip “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga ‘FSHU’ sh.a.” (bashkëlidhur).

2. Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, “KESH” sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., të rishikojnë periudhën kohore, bazën ligjore, nenet 1, 2, pika 3; 12, 18, 21 pika 1, emërtimin e aneksit nr. 1, emërtimin e aneksit nr. 2 dhe pikën 1.1, të nenit 1, të aneksit nr. 1, të kontratës së dërguar në ERE sipas konstatimeve të këtij vendimi.

3. Kontrata e nënshkruar nga palët me ndryshimet sipas pikës 2 në këtë vendim, të dërgohet në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi. Me miratimin e kësaj kontrate shfuqizohen të gjitha aktet që bien në kundërshtim të saj.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë “KESH” sh.a., “FSHU” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Nr. 2436/2 prot., datë 31.05. 2024

Nr. 3823 prot., datë 30.05. 2024

**KONTRATË TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E
SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI, KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A.
(KESH SH.A.) DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A. (FSHU SH.A.), PËR
FURNIZIMIN E KLIENTËVE UNIVERSALË PËR PERIU DHËN KOHORE**

01/01/2024 – 31/12/2024

E lidhur sot më datë 30.05.2024 ndërmjet:

Shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH) SH.A., shoqëri aksionare regjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Rrugën “Viktor Eftimiu”, Blloku Vasil Shanto, Tiranë, Shqipëri, me NUIS J61817005F, e përfaqësuar nga **Z. Erlind Sulo**, Administrator i shoqërisë që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

dhe

Shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” SH.A., shoqëri aksionare, regjistruar në 30.03.2018 në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530016L, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Algert Luzi**, Administrator i shoqërisë, që më poshtë do të quhet “Blerësi”

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si “Palët” dhe me vete si “Pala”)

Baza ligjore:

- Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neni 20 gërma h);
- Vendimi Nr. 456, datë 29.06.2022 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.7.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, i ndryshuar;
- Vendimi i Bordit të ERE Nr. 112, datë 08.07.2016 “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”,
- Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit dhe e Klerimit dhe e Shlyerjes);

- Vendimi Nr. 23, datë 25.03.2009 i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.”, i ndryshuar;
- Vendim Nr. 271, datë 19.09.2023, i Bordit të ERE-s “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH) sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Vendimi nr. 164, datë 04.11.2019 i Bordit të ERE-s “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU SH.A.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;
- Urdhër Nr. 217, datë 29.12.2023 i Ministrit përgjegjës për Energjinë “Për një ndryshim në urdhërin nr. 28, datë 18.01.2021 “Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar
- Vendimi i Ministrit përgjegjës për Energjinë Nr. 936/1 Prot., datë 14.02.2024 (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik) i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për vitin 2024.

Në kushtet kur:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) SH.A., në aktivitetin e licencuar të furnizuesit është ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për kategorinë e klientëve universalë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit me energji elektrike, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Vendimit nr. 449, datë 15.06.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike” dhe vendimit Nr. 112, datë 08.07.2016 të Bordit të ERE “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”;
- Furnizuesit të Shërbimit Universal i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;
- Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar është e detyruar të furnizojë Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme të energjisë, për qëllime të plotësisht të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal.
- Në bazë të Urdhërit Nr. 217, datë 29.12.2023 i Ministrit përgjegjës për Energjinë “Për një ndryshim në urdhërin nr. 28, datë 18.01.2021 “Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar, duke filluar nga 01.01.2024, ka detyrimin të tregtohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX), energjia elektrike për furnizimin e klientëve nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit dhe klientëve me status të veçantë. Për këtë arsye, marrëdhëniet mes palëve për sasinë e energjisë që do të tregtohet në ALPEX, do të rregullohen bazuar në parashikimet e pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.

- Në dispozitat kalimtare të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, parashikohet që kushtet e parashikuara në këtë VKM do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në bërjen funksionale dhe likuide të bursës së energjisë. Çmimi për njësi i energjisë elektrike, për qëllime të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik përkundrejt Furnizuesit të Shërbimit Universal, është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti.
- Ministri përgjegjës për energjinë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë) me vendimin Nr. 936/1 Prot., datë 14.02.2024, ka miratuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal në kuadër të detyrimit për shërbim publik nga shoqëria e prodhimit aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti.

Palët bien dakord lidhur me përmbajtjen e kontratës tip të shit-blerjes së energjisë elektrike në kuadër të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik si më poshtë vijon:

NENI 1

QËLLIMI I KONTRATËS

Kjo Kontratë (së bashku me Shtojcat apo anekset e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve për plotësimin e kërkesës së Blerësit për periudhën kohore 1 Janar-31 Dhjetor 2024.

NENI 2

SASIA E KONTRAKTUAR DHE ÇMIMI I SHITJES

1. Sasia e kontraktuar, nominuar për vitin, që Shitësi është i detyruar të furnizojë Blerësin, është e gjithë sasia e nevojshme për plotësimin e kërkesës së plotë të Blerësit, kjo referuar programeve mujore/javore/ditore/day ahead/intra-day sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 5 të kësaj kontrate.
2. Energjia e cila ka për destinacion përdorimi furnizimin e klientëve universalë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tensionit 6/10 KV dhe klientët me status të vecantë të lidhur në nivel tensioni 20 kV nën shërbimin FMF, tregëtohet mes palëve nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë.
3. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin 2024 është ai i miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit Nr.936/1 Prot., datë 14.02.2024.
4. Për energjinë e furnizuar për realizimin e shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, palët rregullojnë marrëdhëniet tregtare sipas aneksit II që i bashkëlidhet kësaj kontrate “Për rregullimet financiare të marrëdhënies së shitblerjes e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a.dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a.”.

NENI 3

PËRKUFIZIMET

1. **“Referencat në Kohë”** - Referencat e kohës do të jenë sipas Kohës Qendrore Evropiane (CET).
2. **“Përputhja me Aktet nënligjore dhe Rregullat e Tregut”** - Kjo Kontratë hartohet në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike. Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë, ky parashikim në kontratë konsiderohet i pavlefshëm/pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.
3. **“Sasia e kontraktuar”** – sasia totale e energjisë referuar programeve mujore/ javore/ditore/intra-day të “FSHU” SH.A. për klientët universalë objekt i kësaj kontrate.
4. **“Aneksi Nr. 1”** parashikimi sasivë të plotë vjetore të konsumit të “FSHU” SH.A.
5. **“Aneksi Nr. 2”** Për rregullimet financiare të marrëdhënies së shitblerjes e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik , aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a.
6. **“Çmimi i kontratës”**- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë publike së prodhimit, KESH SH.A., në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar.
7. **Dita e Punës:** do të thotë një ditë (përveç së shtunës dhe së dielës) në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila Palë ka zyrën e saj të regjistruar;
8. **“Përgjegjësia për Balancimin”** shitësi dhe blerësi janë përgjegjës për të balancuar pozicionin e tyre në tregun e energjisë
9. **“Koha Qendrore Evropiane”** ose **“CET”** do të thotë Koha Qendrore Evropiane dhe do të përfshijë Kohën Dimërore Qendrore Evropiane dhe Kohën Verore Qendrore Evropiane sipas zbatimit;
10. **“Kapaciteti i Kontratës ”** lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë, kapaciteti i vendosur mes Palëve, i shprehur në MWH.
11. **“Dëmet”** ka kuptimin e specifikuar në nenin 13. **(Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare)**
12. **“Pala që nuk përmbush detyrimet”** ka kuptimin e specifikuar në nenin 11 **(Pezullimi i Livrimit);**
13. **“Filial”** lidhur me një Palë do të thotë një Njësi e Kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ajo Palë, çdo Njësi që Kontrollon direkt ose indirekt atë Palë ose çdo Njësi direkt ose indirekt nën Kontrollin e përbashkët të një Pale
14. **“Pika e Livrimit”** lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë pika e livrimit e vendosur mes Palëve;
15. **“Programi i Livrimit”** lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë programi i livrimit i vendosur mes Palëve për ditën në advance sipas rregullave përkatëse;
16. **“Data e Pagesës”** ka kuptimin e specifikuar në nenin 14 **(Faturimi dhe Pagesa)**
17. **“Data e Hyrjes në Fuqi”** ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj Kontrate;
18. **“Programi”** ka kuptimin e specifikuar në nenin 6, pika 3 dhe 7.2 **(Përkufizimi i Programit)** dhe **“I Programuar”** dhe **“Programimi”** do të interpretohen sipas kësaj;

19. **"Taksë"** do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksë importi, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjobat dhe shtesat e tyre) që vendoset nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij) lidhur me çdo pagesë sipas Kontratës përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë taksë të ngjashme;
20. **"Instrument financiar"** nënkuptojnë marrëveshje për faturimin reciprok të diferencës midis çmimit klerues për njësi kohore të tregut (të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë) për ditën e lëvrimit me çmimin e parashikuar në marrëveshjen e lidhur midis palëve, të cilat sigurojnë pjesëmarrësit ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg.
21. Çdo term tjetër i përdorur në këtë kontratë do të lexohet në kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT

1. Blerësi, bazuar në kërkesën vjetore për energji, Aneksi Nr. 1 i kësaj kontrate, dhe në trendin e ngarkesës do t'i paraqesë Shitësit brënda datës 30 tetor, programin vjetor të ndarë me bazë mujore të ngarkesës së klientëve universalë, në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike
2. Blerësi jo më vonë se 7 ditë kalendarike përpara fillimit të muajit të furnizimit do t'i dërgojë Shitësit gjithë të dhënat që lidhen me parashikimin e ngarkesës për muajin pasardhës me bazë ditore dhe orare të ngarkesës.
3. Blerësi jo më vonë se dita e enjte e çdo jave do ti dërgojë Shitësit të dhënat që lidhen me ngarkesën e klientëve universalë për sasinë e javës në avancë me bazë ditore/orare.
4. Blerësi brenda orës 12:00 të çdo dite do ti dërgojë Shitësit programin e ditës në avancë me bazë orare të ngarkesës sipas afateve të përcaktuara në Rregullat e Tregun Shqiptar të Balancimit.
5. Blerësi, në rastet kur është e nevojshme, brenda orës 15:00 do t'i dërgojë Shitësit përditësim të kërkesës për furnizimin e klientëve fundore për ditën D+2, me bazë orare me qëllim garantimin e furnizimit të plotë për periudhën vijuese.
6. Blerësi pas mbylljes së bilancit energjetik, të muajit duhet t'i dërgojë Shitësit informacionin mbi sasinë e energjisë së faturuar dhe informacione të tjera për qëllim të përmbushjes së detyrimeve të kësaj kontrate.
7. Blerësi i dërgon shitësit të dhënat lidhur me furnizimin e energjisë për FMF sipas parashikimeve të Aneksit II.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

1. Shitësi bazuar në programet mujore/javore/ditore në day-ahead dhe intra-day do të sigurojë përmbushjen e kërkesës së Blerësit.
2. Shitësi kompenzon blerësin për çmimin e energjisë elektrike sipas parashikimeve të Aneksit II të kësaj kontrate.

NENI 6

DETYRIMET KRYESORE PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE

1. **Përgjegjësia për balancimin e energjisë:** Shitësi dhe blerësi janë subjekte të rregullave në fuqi për balancimin dhe për rrjedhojë përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike përkundrejt OST (deri sa nuk kanë një marrëveshje që rregullon përgjegjësinë e balancimit me të tretët).
2. **“Nominimi (Livrimi dhe Pranimi)”:** Shitësi dhe blerësi do të nominojnë në Platformën e OST për nominimet. Bazuar në konfirmimet e bëra paraprakisht, çka përbën konfirmimin për livrimin (Shitësi) dhe pranimin (Blerësi) e energjisë elektrike objekt i kësaj kontrate. Sasia e programuar nga palët në sistemin për nominime të OST është sasia kontraktuale për të cilën Blerësi do të paguajë Shitësit me çmimin e përcaktuar në nenin 2 të Kontratës.
3. **Program** sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit dhe pranimit, që përfshin programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, agjentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës apo me OST, Sasinë e Kontratës, Kapacitetin e Kontratës, Pikën e Livrimit, Programin e furnizimit, Periudhën Totale të Furnizimit, dhe çdo kusht tjetër të Kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

NENI 7

LIVRIMI, MATJA, TRANSMETIMI DHE RISKU

1. **Rryma/Frekuenca/Tensionet:** Energjia Elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në Pikën përkatëse të Livrimit sipas standarteve të parashikuara në Kodet dhe Rregullat në fuqi.
2. **Programet e Deklaruara:** Sasia e Energjisë Elektrike që do të programohet dhe konfirmohet nga Shitësi për Blerësin, do t'i furnizohet këtij të fundit mbi baza vjetore, mujore, javore, ditore dhe orare në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike si dhe Kodet e Rrjetit. Nominimi fizik/programi i livrimit për ditën e nesërme duhet paraqitur në përputhje me Rregullat e Tregut dhe Kodet në fuqi.
3. **Dokumentacioni i Livrimeve dhe Marrjeve në Dorëzim:** Bazuar në një kërkesë të arsyeshme, Palët:
- do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë ose do të kontrollojë paraqitjen e Programeve, sasive, livrimeve dhe pranimit të energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të Kontratës Individuale dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike (referuar nominimit në Platformën e OST për nominimet).
4. **Risqet e Shitësit dhe Blerësit:** Shitësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, transmetimit dhe livrimit të sasisë së energjisë së parashikuar në Kontratë deri në Pikën e Livrimit. Blerësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të programimit, pranimit dhe transmetimit të Sasisë së Kontratës në dhe nga Pika e Livrimit.
5. **Pikat e Livrimit:** Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në kufijtë e sistemit të transmetimit të OST, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.

NENI 8

MOS-PERFORMANCA PËR SHKAK TË FORCËS MADHORE

1. **Përkufizimi i Forcës Madhore:** Përveç se kur specifikohet ndryshe, “**Forcë Madhore**” për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore (“**Pala Pretenduese**”), siç përcaktohet në Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - a) defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose
 - b) pezullimi nga OST-ja përkatëse i livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
2. **Çlirimi nga Detyrimet e Livrimit dhe Pranimit:** Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë Kontratave dhe kjo Palë respekton kërkesat e pikës **8.3 (Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore)**, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjeshtë pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas pikës **8 (Zhdëmtimet për Paaftësinë për Livrim dhe Pranim)** nuk do t’i merret Palës Pretenduese lidhur me sasishtë e pa livruara ose të pamarra.
3. **Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore:** Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t’i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimit të Forcës Madhore, do t’i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
4. **Efektet e Forcës Madhore mbi Palën Tjetër:** Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.

NENI 9

RAKORDIMI I SASISË SË ENERGJISË TË LEVRUAR PËR QËLLIM TË FURNIZIMIT TË KLIENTËVE

1. Shitësi dhe Blerësi jo më vonë se data 10 e muajit do të rakordojnë sasishtë energjisë elektrike që kanë shkuar për furnizimin e klientëve universalë, sasi e cila është energjia elektrike totale e nominuar në sistemin për nominime të OST dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë ALPEX.
2. Me mbylljen e bilancit mujor të shoqërisë FSHU, jo më vonë se data 25 e muajit pasardhës, do të rakordohet mbi:
 - a) Sasinë e energjisë elektrike që nuk ka patur destinacion furnizimin e klientëve universalë por kapatur destinacion mbulimin e humbjeve dhe/ose furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit

- në tregun e lirë. Kjo sasi do të transferohet në marrëdhënien kontraktuale KESH-FTL, ndërsa për efekt të kësaj kontrate Shitësi do të bëjë një faturë sistemuese për FSHU.
- b) Sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi e cila ka shkuar për FSHU. Kjo sasi, është teprica nga prodhimi i burimeve të rinovueshme që rezulton nga energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme që tejkalojnë sasinë e pambuluar të humbjeve totale dhe nevojave të furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë sipas bilancit energjetik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë. Sasinë e energjisë elektrike të evidentuara sipas pikes a) dhe b) do të transferohen në marrëdhënien kontraktuale KESH-FTL. Për efekt të kësaj kontrate Shitësi do të bëjë në fund të vitit një faturë sistemuese për FSHU. Pagesat sipas faturave sistemuese mes palëve do të bëhet brenda 45 ditëve nga dita e fundit e livrimit për muajin përkatës.
- c) Sasinë e energjisë elektrike që ka shkuar për furnizimin e klientëve, ndarë sipas destinacionit të shitjes së energjisë apo fashës së furnizimit, në referencë të pikës 6, të Nenit 3 të kësaj kontrate, konkretisht :
- i. klientët e furnizuar në TM 6/10 dhe klientët 20 kV me status të veçantë
 - ii. klientët – shoqëritë e UK në TM 6/10/20/35 kV ;
 - iii. klientët fundorë të lidhur me nivel tensioni 0,4 kV.
3. Për qëllim të zbatimit të kësaj kontrate dhe parashikimeve të nenit 9, palët do të menaxhojnë nëpërmjet marrëveshjes financiare pjesë e kësaj kontrate (Aneksi 2) sasinë e energjisë të cilat shiten për mbulimin e nevojës së klientëve në TM. Në çdo rast sasia e energjisë e nominuar në ALPEX për klientët që furnizohen në TM, do të jetë e tillë që të lejojë palët të rakordojnë në fund të muajit të livrimit sasinë reale me destinacion këta klientë.

NENI 10

MOS PERFORMANCE TË LËVRIMIT OSE PRANIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

1. **Rasti i mos-performancës ana e shitësit:** Në atë shkallë që Shitësi - Pala që ka detyrimin për livrimin e energjisë elektrike ("Pala Livruese") nuk i livron tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë të përcaktuar/rakorduar për ditën në avance, intra-day, dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Pala Livruese do t'i paguajë Palës tjetër ("Pala Pranuese") një shumë si kompensim për atë sasinë të palëvruar me energji elektrike me koston e sigurimit të kësaj energjie.
2. **Rasti i mosrespektimit nga ana e blerësit:** Në rastin kur Blerësi ("Pala Pranuese") dështon të pranojë tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë elektrike të rakorduar për ditën në avancë dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Pala pranuese do t'i paguajë Palës tjetër ("Pala Livruese") një shumë si kompensim për dëmtimet si kompensim për atë sasi të papranuar me energji elektrike me koston e sigurimit të kësaj energjie nga KESH.
3. **Shuma e pagueshme:** shumat e pagueshme sipas këtij neni do të faturohen dhe pagohen sipas Nenit 14 (Faturimi dhe pagesa).

NENI 11

PEZULLIMI I LIVRIMIT

Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera të mundshme, nëse "Pala që nuk përmbush detyrimet" nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur sipas Kontratës, ose sipas kushteve të garancive nëse do aplikohen nuk arrin ta sigurojë, apo zëvendësojë vlerën e kërkuar sipas Kontratës, Pala që përmbush detyrimet do të autorizohet jo më parë se tre (3) Ditë Pune pas dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike dhe të çlirohet (jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit sipas gjithë Kontratave specifike deri kur Pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e tjera) të gjithë shumave të papaguara që i detyrohen palës që përmbush detyrimet.

Pezullimi i livrimeve, apo çlirimeve të detyrimeve të tjera të livrimit, nga Palët mund të bëhet vetëm me miratimin e ERE.

NENI 12

KOHËZGJATJA

Kontrata është e vlefshme për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor të vitit 2024.

NENI 13

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË FINANCIARE

1. **Përfshirja e Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikave 13.2 dhe 13.3 dhe përveç kur lidhet me shumën e pagueshme sipas nenit 8 (**Zhdëmtimet**), një Palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj Palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm ("**Dëmet**"), (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një Kontrate specifike) që pëson Pala tjetër sipas Marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto Dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mos pagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një Pale ose punonjësve, zyrtarëve, përdorur nga kjo Palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas Kontratës.
2. **Dëmi Pasues dhe Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikës 13.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas Kontratës ose lidhur me të:
 - (a) nuk përfshin përgjegjësinë financiare për Dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe
 - (b) kufizohet me një shumë të barabartë me shumën e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një Palë sipas çdo Kontrate specifike përkatëse me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 8 (**Zhdëmtimet për Paafësinë për Livrim dhe Pranim**).
3. **Mos pagesa e Qëllimshme, Mashtrimi dhe të Drejtat Themelore:** Asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të Palës për:
 - (a) mos pagesën e qëllimshme,
 - (b) mashtrimin; ose
 - (c) çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një Pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një Pale.
4. **Detyra për Lehtësimin e Humbjeve:** Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i Legjislacionit në Fuqi, çdo Palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë Dëmet dhe premtori që do të përdorë përpjekje

komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo Dëmi që mund të pësojë sipas Kontratës ose lidhur me të.

NENI 14

FATURIMI DHE PAGESA

1. **Faturimi:** Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë elektronike sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të Energjisë Elektrike të lëvruar nga shitësi te blerësi sipas parashikimeve të nenit 9 pika 1, në monedhën Lekë.
Për qëllime të zbatimit të pikës 3 të nenit 2 të kontratës, kur nga Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen nga shteti, janë përcaktuar cmime të shitjes së energjisë elektrike sipas destinacionit të përdorimit nga ana e shoqërisë së furnizimit (kategoria e klientit sipas nivelit të tensionit ku furnizohet dhe/ose fashës së konsumit mujor kur aplikohen çmime të ndryshme shitjeje).
Sasi të e energjisë e nominuar në sistemin për nominime të OST do të faturohet me cmimin e përcaktuar për nivelin e tensionit 0.4 kv. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të Muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike.
2. **Saktësimi i faturimit:** Shitësi mbi bazën e të dhënave të rakorduara ndërmjet palëve sipas parashikimeve të nenit 9 duhet të korrektojë faturat e lëshuara sipas pikës 1 të këtij neni, duke lëshuar përkatësisht, në monedhën Lekë :
 - a) faturë për energjinë faktike të livruar për klientët e ndryshëm nga klientët universalë në kategorinë Ujësjellës Kanalizime, çmim, i cili është miratuar dhe me Vendimin Nr.46, datë 02.04.2024 të Entit Rregullator të Energjisë.
 - b) një faturë saktësuese financiare referuar në energjinë faktike të livruar për klientët e furnizuar në TM 6/10/ kV dhe 20 kV me status të veçantë, sipas Nenit 9, shkronja (c), pika (i) dhe Aneksit II të kontratës (Nenit 2, pika 4), për energji të shitur në ALPEX por të përdorur për furnizim për klientët në tension 0.4 KV.
 - c) një faturë për energjinë faktike për klientët universalë për energji të faturoar mbi fashën me tarifë të rregulluar, nëse është aplikuar, dhe
 - d) një faturë saktësuese për klientët në tension 0.4 KV për sasinë e energjisë që rezulton si diferencë midis sasisë totale të faturoar sipas pikës 1 të këtij neni me energjinë e faturoar sipas shkronjës (a) dhe (c) të kësaj pike.
 - e) një faturë për periudhë livrimi të energjisë elektrike 12 mujore, për sasinë e përcaktuar sipas gërmës b) të pikës 2, neni 9, e cila ka patur destinacion furnizimin e klientëve universalë.

Pagesa: Pagesa e faturës principale do të bëhet brenda 45 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore. Për faturat sistemuese, data e pagesës do të jetë e njëjta me faturën principale për të cilën bëhet sistemimi. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.

Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

NENI 15

TAKSAT DHE TATIMET

Çdo çështje që lidhet me taksat dhe tatimet rregullohet në përputhje me legjislacionin respektiv për taksat dhe tatimet në Republikën e Shqipërisë.

NENI 16

TRANSFERIMI

1. **Ndalimi:** Asnjëra Palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme. Çdo transferim i të drejtave dhe detyrimeve bëhet efektiv pas miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).
2. **Transferimi tek Filialet:** Çdo Palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, një Filiali me aftësi paguese të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër dhe miratimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

NENI 17

PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Për të adresuar riskun e çdo Pale, përsa i përket mundësisë për përmbushjen e detyrimeve të palës tjetër, dhe për të siguruar përmbushjen e të gjithë detyrimeve që rezultojnë nga kjo Kontratë apo kontrata specifike, Palët mund të dakortësojnë, më parë apo në çdo kohë pas hyrjes në fuqi, ose në kohën pas nënshkrimit të kontratave specifike, ekzistencën e mbështetjes me garanci kredie dhe Garantues sipas kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të dakortësuara prej tyre

NENI 18

PERSONAT E KONTAKTIT

Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me email ose faks:

Për Furnizuesi i Shërbimit Universal	Për KESH
Administratori i Kontratës	
Z/Znj. Ornela Barko	Z/Znj. Rakela Llanaj
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr.88, Tiranë	Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë
Tel: _____	Tel.: _____
Cel: 0694143777	cel: 0694033490
E-mail: ornela.barko@fshu.al	E-mail: llanajr@kesh.al
Programimi	
Z/Znj. Ermira Staka	Z/Znj. Aurora Bego
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr.88, Tiranë	Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë
	Tel.: _____

Tel: _____ Cel: 0694147922 E-mail: ermira.staka@ftl.al	cel: 0672135152 E-mail: begoa@kesh.al
Back Office	
Z. Julind Toçila/Arbër Iljazi Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr.88, Tiranë Tel: _____ Cel: 0676357843/0686676777 E-mail: julind.tocila@fshu.al /arber.iljazi@fshu.al	Z/Znj. Arben Tase Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: _____ Cel : 0697033335 E-mail: tasea@kesh.al

NENI 19

LEGJISLACIONI NË FUQI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- Legjislacioni në Fuqi:** Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve:** Nëse palët nuk arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet për zgjidhje EREs. Sa më sipër nuk përjashton të drejtën e palëve për të adresuar nëpërmjet Gjykatës zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje të krijuar në interpretim apo kuptim të kësaj kontrate.

NENI 20

TË NDRYSHME

- Njoftimet dhe Komunikimet:** Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palët, gjithë njoftimet, deklaratat e dërguara nga një Palë tjetër duhet të jenë me shkrim (postë të shpejtë ose korrier). Çdo Palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:
 - nëse shpërndahen dorazi Ditën e Punës, ose Ditën e parë të Punës pas datës së fundit të livrimit;
 - nëse dërgohen me postë, Ditën e 2^{te} të Punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në Ditën e 5^{te} të Punës pas datës së postimit;
 - nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17.00 (me orën e marrësit) në Ditën e Punës ose në orën 09.00 (me orën e marrësit) në Ditën e parë të Punës pas transmetimit.
- Amendimet:** Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët, dhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.
- Pavlefshmëria e Pjesshme:** Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Kontrate, nuk do të preken.

ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Në rast se legjislacioni në fuqi sjell ndryshime të dispozitave të kësaj kontrate, deri në miratimin nga ERE të këtyre ndryshimeve, legjislacioni i zbatueshëm do të prevalojë në kuptimin dhe interpretimin e këtyre dispozitave.

NENI 21

MIRATIMI I ERE-S DHE EFEKTET

1. Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor për vitin 2024.
2. Palët kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n lidhur me nënshkrimin e kësaj kontrate, e cila hyn në fuqi pas miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë.
3. Kjo kontratë Tip mund të ndryshohet vetëm me miratimin e Entit Rregullator të Energjisë.
4. Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

“Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” SH.A.

“Furnizuesi i Shërbimit Universal” SH.A.

Erlind Sub
ADMINISTRATOR

Alban Koz
ADMINISTRATOR



Shtojca 1: Programet e livrimit sipas Neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate

Shtojca 2: Sipas Nenit 19, të kësaj kontrate “Pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të Palëve për regjistrimet telefonike”

ANEKSI NR. 1

“Parashikimi i sasisë së plotë vjetore të konsumit të FSHU SH.A. për vitin 2024”

Ndërmjet shoqërive:

Në datë ____/____/____, KESH sh.a. ka livruar/nonimuarnë sistemin për nominime të OST energjinë elektrike sipas raportit të mëposhtëm:

Data/Ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Totale
01/ /2024																									
02/ /2024																									
03/ /2024																									
04/ /2024																									
05/ /2024																									
06/ /2024																									
07/ /2024																									
08/ /2024																									
09/ /2024																									
10/ /2024																									
11/ /2024																									
12/ /2024																									
13/ /2024																									
14/ /2024																									
15/ /2024																									
16/ /2024																									
17/ /2024																									
18/ /2024																									
19/ /2024																									
20/ /2024																									
21/ /2024																									
22/ /2024																									
23/ /2024																									
24/ /2024																									
25/ /2024																									
26/ /2024																									
27/ /2024																									
28/ /2024																									
29/ /2024																									
30/ /2024																									
31/ /2024																									

- Sasia totale e energjisë e nominuar në sistemin për nominime të OST dhe ALPEX _____
- Sasia e energjisë elektrike për efekt shkëmbimi/humbje _____
- Sasia e energjisë e nominuar nga FSHU SH.A. për:
 - Klientët universalë _____
 - Klientët e ndryshëm nga klientët universalë _____

Konfirmuar nga KESH:

Konfirmuar nga FSHU:

Nr. 2436/3 Prot., datë 31.05.2024

Nr. 3823/ Prot., datë 30.05.2024

ANEKSI II
PËR RREGULLIMET FINANCIARE TË MARRËDHËNIES SË SHITBLERJES TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI, KESH SH.A. DHE
FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SH.A., PËR PERIUDHËN KOHORE
01.01.2024-31.12.2024

E lidhur sot më datë 30.05.2024 ndërmjet:

Shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH) SH.A., shoqëri aksionare regjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Rrugën “Viktor Eftimiu”, Blloku Vasil Shanto, Tiranë, Shqipëri, me NUIS J61817005F, e përfaqësuar nga Z. **Erlind Sulo**, Administrator i shoqërisë që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

dhe

Shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” SH.A., shoqëri aksionare, regjistruar në 30.03.2018 në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530016L, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. **Algert Luzi**, Administrator i shoqërisë, që më poshtë do të quhet “Blerësi”

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si “Palët” dhe me vete si “Pala”)

Palët me vullnetin e tyre të lirë e të përbashkët bien dakord lidhur me përmbajtjen e këtij Aneksi të kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike, me qëllim rregullimin financiar të marrëdhënies së shitblerjes së energjisë elektrike në kuadër të përmbushjes së detyrimit për shërbimin publik për furnizimin e FSHU SH.A. të sasisë së energjisë që përdoret për përmbushjen e detyrimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, si më poshtë vijon:

NENI 1

Qëllimi

1.1 Ky Aneks, si pjesë e kontratës Tip së shitblerjes së energjisë elektrike (së bashku me Shtojcat e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien financiare të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet Palëve për plotësimin e kërkesës së Blerësit për energji për përmbushjen e detyrimit si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) për periudhën kohore 01.01.2024 – 31.12.2024.

Marrëdhënia e shitjes dhe e blerjes së energjisë fizike ndërmjet Palëve për plotësimin e kërkesës së Blerësit për energji për përmbushjen e rolit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF) do të

realizohet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë që më poshtë do të quhet “ALPEX”, në ditën në avancë.

NENI 2

Përkufizime

- 2.1 Sasia e kontraktuar** - është sasia totale e energjisë e kontraktuar mes palëve në ALPEX.
- 2.2 Çmimi i shitjes së energjisë fizike** - është çmimi që do të rezultojë në bazë ditore nga shitblerja e energjisë në ALPEX.
- 2.3 Çmimi i rregulluar i energjisë elektrike** – është çmimi i shitjes së energjisë elektrike i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë publike së prodhimit, KESH SH.A., në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar.
- 2.4 Vlera e kompensimit** - është vlera që do të rezultojë si diferencë e çmimit të shitjes në ALPEX dhe çmimit të rregulluar të shitjes, në bazë ditore, për sasitë e qarkulluara të energjisë mes palëve. Palët do të rakordojnë mes tyre sipas Shtojcës Nr. 1 pjesë e këtij Aneksi.

NENI 3

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

- 3.1** Para hapjes së portës së ofertimit në DAM/ ALPEX, Blerësi dhe Shitësi do të rakordojnë me njëri-tjetrin programin ditor të energjisë me bazë orare të parashikuar për nevojat e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 6/10 kV dhe 20 kV me status të veçantë, në përputhje me dispozitat e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe parashikimeve të kontratës.
- 3.2** Palët do të paguajë njëra tjetrën për energjinë e qarkulluar sipas çmimeve që do të rezultojnë në ALPEX për ditën në avancë.
- 3.3** Shitësi bazuar në programet javore/ditore dhe përpara hapjes së portës, do të sigurojë përmbushjen e kërkesës së Blerësit, nëpërmjet ALPEX.
- 3.4** Shitësi do të kompesojë diferencën e çmimit mes çmimit të shitjes së energjisë për ditën në avancë në ALPEX dhe çmimit të rregulluar të energjisë, miratuar nga organet drejtuese sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456 datë 29.06.2022, i ndryshuar.
- 3.5** Blerësi do të kompensojë diferencën e çmimit, mes çmimit të rregulluar të energjisë miratuar nga organet drejtuese sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456 datë 29.06.2022, i ndryshuar dhe çmimit të shitjes së energjisë për ditën në avancë në ALPEX.
- 3.6** Kompensimet nga Shitësi dhe nga Blerësi, do të bëhen në monedhën Euro. Konvertimi në Euro i çmimit sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456 datë 29.06.2022, i ndryshuar, do të bëhet me kursin e këmbimit si në faturën nga ALPEX për të njëjtën datë livrimi.

NENI 4

Faturimi dhe pagesa

- 4.1 Fatura:** Të dyja palët pasi kanë kleruar sasitë e energjisë në ALPEX në ankandin përkatës për cdo Njësi Kohore Tregtimi për ditë të caktuara livrimi, do të bëjnë rregullimin nëpërmjet faturimit për diferencën midis çmimit klerues për Njësi Kohore të Tregut për këtë ditë livrimi me çmimin e parashikuar në kontratë. Fatura do të jetë ditore, me qëllim barazimet financiare të energjisë sipas pikës 6, të këtij neni dhe do të lëshohet nga pala e cila mban të drejtën e kompensimit. Fatura do të lëshohet në raportin e hartuar nga palët sipas pikës 2, të këtij neni. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet në ditën D për cdo proces ankandi në

DAM të ditës D-1, dhe kur kjo ditë është ditë pushimi dhe ose festë zyrtare, ditën e ardhshme më të parë të punës, për secilin proces ankandi të ditës D-1.

- 4.2 Raporti:** Palët do të hartojnë një raport i cili pasqyron diferencat midis çmimit të DAM/ALPEX dhe çmimit të kontraktuar për sasi të energjisë që shitësi i ka shitur blerësit gjatë një dite, sipas parashikimeve të kësaj kontrate. Ky raport do të shërbejë për lëshimin e faturës sipas pikës 1, të këtij neni.
- 4.3 Pagesa:** Palët do të paguajnë vlerën e faturës sipas pikës 1 brenda ditës së nesërme të lëshimit të faturës dhe ekzekutimit të pagesës së faturës së shitjes së energjisë në ALPEX, në llogarinë bankare të dedikuar për transaksione e kryera në Bursë. Data e pagesës do të konsiderohet data kur fondet janë transferuar nga llogaria e blerësit.
- 4.4 Vonesa në kryerjen e pagesës:** Nëse pala nuk arrin të kryejë pagesën brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, penaliteti për dëmet e shkaktuara si pasojë e vonesës do të llogaritet në përputhje me ligjin nr.48/2014, “Për vonesat në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, i ndryshuar.
- 4.5 Përkufizimi i Kontratës në treg:** Kjo Kontratë do të trajtohet si Kontratë OTC në DAM ALPEX, ku i jepet përparësi përputhjes së Urdhër Porosive të blerësit dhe shitësit. Si Blerësi ashtu edhe Shitësi do të krijojnë një portofol (të dedikuar për zbatimin e detyrimeve të OTC) në ALPEX DAM për të përmbushur vëllimet sipas kësaj Kontrate.
- 4.6 Barazimet financiare të energjisë elektrike:** ALPEX do të sigurojë shlyerjen e volumit të kontraktuar në ALPEX DAM, sipas Rregullave të Tregut. Nëse çmimi klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM është më i lartë se çmimi i kontratës, Shitësi do të kompensojë blerësin për diferencën midis çmimit klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM dhe çmimit të kontratës. Përkatësisht, nëse çmimi klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM është më i ulët se çmimi i kontratës, blerësi do të kompensojë shitësin për diferencën ndërmjet çmimit klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM dhe çmimit të kontratës.
- 4.7 Realizimi i Transaksioneve dhe Tregtimi:** Tregtimi i energjisë elektrike përfshin përputhjen e Urdhërporosive të blerjes dhe shitjes dhe do të bëhet sipas dispozitave të rregullave të tregut të ALPEX. Volumet që do të kërkojë Blerësi në përputhje me parashikimet e kësaj kontrate për një ditë të caktuar levrimi dhe për cdo njësi kohore tregu, do të ofertohen në Sistemin e Tregtimit të Energjisë (ETSS) në përputhje me dispozitat Rregullave të ALPEX-it dhe procedurat, nëpërmjet portofolit të tij, ndërkohë shitësi duhet që po nëpërmjet portofolit të tij (të dedikuar për zbatimin e OTC) të ofertojë për të njëjtën ditë levrimi dhe të njëjtat volume për cdo Njësi Kohore Tregu.

NENI 5

Hyrja në fuqi

- 5.1** Ky Aneks kontrate nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.
- 5.2** Ky Aneks nënshkruhet nga palët dhe hyn në fuqi pas miratimit nga ERE.

“Korporata Elektroenergjitike
Shqiptare” SH.A.

Erlind Subo
ADMINISTRATOR


“Furnizuesi i Shërbimit Universal”
SH.A.

Ilir
ADMINISTRATOR


SHTOJCA 1

RAKORDIM DITOR KESH SH.A. –FSHU SH.A.

Ndërmjet shoqërive:

Për periudhën2024, KESH sh.a. ka livruar dhe FSHU sh.a. ka pranuar energjinë elektrike për mbulimin e nevojës për furnizim nën FMF sipas raportit të mëposhtëm:

Data\ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Totale
/ /2024																									
Totale																									

Tipi i kontratës: Kontrate OTC. Kursi i Euro do të merret kursi i ditës së lëshimit të faturës

Data	Sasia MWh	Çmimi mesatar DAM/ALPEX Euro/MWh	Vlera në Euro	Kursi i Këmbimit	Vlera e faturës në lekë	Vlera sipas çmimit të kontratës OTC(lekë/MWh)	Diferenca në lekë	Fatura në Euro	Fatura me TVSH

Konfirmuar nga “KESH” SH.A.:

(emër, mbiemër, firmë)

Konfirmuar nga “FSHU” SH.A.:

(emër, mbiemër, firmë)